



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Cocrra" Sh.P.K. të datës 11.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-10689-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Cocrra" Sh.P.K. të datës 11.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-10689-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Cocrra" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 24.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-10689-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Pozivioni 8, OE - Duhetë të jetë i autorizuar direkt nga Prodhuesi. OE - duhet të ofrojë KATALOG apo Datasheet për pajisjet e ofruara nga Prodhuesi. 1. Sa i perket ketij dokumenti per -, ju njoftojme se njehta eshte kerkese qe per here te pare po kerkohet ne aktivitet te ngjashem, pra sa i perket Furnizim me instalimi i smart bordave, dhe si e tille nuk eshte ne dispozicion te Operatoreve Ekonomik, konkretisht Kompanive qe operojne me furnizime, montime instalimit e smart bordave ,sipas ketij MAF duhet te ken vetem nje komani e cila sipas specikave qe keni vendosur ne params dhe si e till eshte shkelje ligjore dhe eshte favorizim I hapur Favorozim I hapur I brendit ubiquit , gje qe eliminon konkurence ne lir dhe bie ndesh me me Nenin 7 te LPP-se, pasi qe me kerkesen ne fjale AK nuk eshte duke i trajtuar te gjithë OE ne menyre te barabarte dhe eshte duke e reduktuar apo eliminuar konkurencen e lire ne mes te Operatoreve Ekonomik.

c.) Autorizimi nga prodhuesi opo dileri i autorizuar për produktet kryesore nga prodhuesi për pozicionet(10,11,12,13) e Aneksin 1 në dosjën e tenderit. Swich 52 port bredi ubiquit Wifi ruter 7 ubiquit https://dl.ubnt.com/guides/UniFi/UniFi_AP_AP-LR_User_Guide.pdf

Sa i përket dokumentit në fjalë, ju njoftojmë se kërkesa e paraqitur është hera e parë që shfaqet në një aktivitet të këtij lloji, konkretisht në procedurën për Furnizim me instalim të smart board-ave. Si e tillë, kjo kërkesë nuk është e arritshme apo në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë që veprojnë në fushën e furnizimit, montimit dhe instalimit të smart board-ave. Bazuar në MAF-in e publikuar, rezulton se specifikat teknike të vendosura në "params" mund të përmbushen vetëm nga një kompani e vetme, e cila përputhet me karakteristikat e brendit "Ubiquit". Kjo paraqet një shkelje ligjore dhe një favorizim të hapur, duke eliminuar konkurrencën e lirë. Një praktikë e tillë bie ndesh me Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi Autoriteti Kontraktues nuk po i trajton të gjithë Operatorët Ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe po e kufizon ose eliminon konkurrencën e lirë mes tyre. Ne teresi specifikimi Teknik I kerkuar nga ju eshte komplet favorizim I hapur I bdrendit ENS gje qe bie ndesh me nenit Nenin 7 te LPP-se, pasi qe me kerkesen ne fjale AK nuk eshte duke i trajtuar te gjithë OE ne menyre te barabarte dhe eshte duke e reduktuar apo eliminuar konkurencen e lire ne mes te Operatoreve Ekonomik"

c.) Autorizimi nga prodhuesi opo dileri i autorizuar për produktet kryesore nga prodhuesi për pozicionet(10,11,12,13) e Aneksin 1 në dosjën e tenderit.

Fillimisht, kërkesa për autorizim të prodhuesit, e vendosur nga ju si Autoritet Kontraktues, është në kundërshtim me dispozitat e Rregullës së UOPP-së".

Lidhur me pretendimet ankimore: AK vlerëson se pretendimet janë të pabazuara, dhe se specifikat teknike nuk janë përgatitur duke favorizuar një brand të caktuar sikurse pretendon OE. Specifikat teknike për produktet të lartcekura i plotësojnë të paktën 3-4 prodhues. AK sqaron se specifikat teknike janë ri - përgatitur sipas ekspertit shqyrtues të OSHP- se, duke marre për baze rritjen e konkurrencës. Kërkesa për MAF është hartuar në përputhje me RRPP dhe siguron që produktet vijnë nga kanalet zyrtare dhe me garanci

nga prodhuesi pra nuk është shkelje e RRPP sikurse pretendohet. Përndryshe edhe kërkesa për MAF është shqyrtuar nga ekspertët e OSHP.

Duhet sqaruar se OSHP lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka publikuar edhe një vendim me c' rast autoriteti kontraktues ka adresuar të gjitha të gjeturat dhe konstatimet sipas vendimit të OSHP. Kërkesat e mbetura në dosjen e tenderit jo vetëm që janë në përputhje të plotë me vendimin e OSHP, por si të tilla janë kërkesa absolutisht të domosdoshme dhe në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuuese.

Pretendimet ankimore të parashtresit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se këto pretendime jo vetëm që janë të pabazuara në kuptim të kësaj kërkesë për rishqyrtim, por si të tilla tanimë ato janë trajtuar nga OSHP (pra bëhet fjalë për çështje të gjykuara).

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtresë nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtresit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.12.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.